VENDIM
Nr.1100, datë 30.7.2008

PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATMESËM TË VEPRIMIT TË PROGRAMIT "BRAIN GAIN", PËR PERIUDHËN 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të programit "Brain Gain", për periudhën 2008-2009.
2. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t'i shtohet fondi 24 400 000 (njëzet e katër milionë e katërqind mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të efekteve financiare, të vitit 2008, për planin afatmesëm të veprimit të programit "Brain Gain", i cili do të bashkëfinancohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha